



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET EVROPIANE**

**Datë 19.02.2024**  
**Dokument Parlamentar**  
**Komision për dhënie mendimi**

**RAPORT**  
**PËR PROJEKTLIGJIN**  
**PROJEKTLIGJ PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 81/2017**  
**“PËR ZONAT E MBROJTURA”**

- ***Hyrje***

Komisioni për Çështjet Evropiane (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 19, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **19.02.2024**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura””.

Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Z. Etjen Xhafaj.

Për paraqitjen e këtij projektligji në mbledhje ishte i pranishëm Z. Fadil Nasufi, deputet propozues i projektligjit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga një grup deputetësh, sipas përcaktimeve të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, synon përmirësimin e disa elementeve dhe problematikave të vërejtura nga implementimi i ligjit në fuqi për zonat e mbrojtura dhe kryesisht në bashkëpunimin e qeverisjes vendore, komuniteteve dhe administratës së zonave të mbrojtura. Këto problematika janë shfaqur pas miratimit të ligjit në vitin 2017, pa marrë parasysh faktorin e komunitetit që bashkëekziston në këto zona dhe në vitin 2023 kur zonat e mbrojtura përbëjnë 21.5% të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, pra më shumë se 1/5 e vendit, dhe duhet të gjenden zgjidhje që adresohen pa kompromentuar parimet bazë të zonave të mbrojtura atë të ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre.

Objekti i përgjithshëm i projektligjit është evidentimi i parimeve dhe politikave të reja që duhet të zbatohen në zonat e mbrojtura si një evolim i këtyre koncepteve të kryera nga organizmat ndërkombëtare, rezultat i realiteteve të reja dhe i nevojës për një zhvillim të qendrueshëm duke ofruar një mundësi të shkëlqyer zhvillimi, duke krijuar vende pune, ekonomi dhe një perspektivë rajonale.

Ligji sjell koncepte të reja të kategorizimit të biodiversitetit në vend sipas rëndësisë por edhe mundësinë e përditësimit të tij në mënyrë më të shpeshtë si dhe i jep një mundësi qeverisjes lokale dhe komuniteteve të jenë pjesë e kësaj vendimmarrjeje. Qëllimi i ruajtjes dhe mbrojtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura nuk duhet të jetë përjashtues por gjithëpërfshirës duke prezantuar edhe edukimin përmes mjedisit.

- Shqipëria me miratimin e ligjit nr.102/2023 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Unionin ndërkombëtar për konservimin e natyrës (IUCN)”, ka aderuar dhe është anëtare në Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN), i cili ka si objektiv kryesor që të ndikojnë, inkurajojnë dhe ndihmojnë shoqëritë në mbarë botën për të ruajtur integritetin dhe diversitetin e natyrës dhe për të garantuar që çdo përdorim i burimeve natyrore të jetë i barabartë dhe ekologjikisht i qëndrueshëm.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është konform normave kushtetuese dhe i harmonizuar me legjislacionin në fuqi.

- ***Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm***

Bazuar në nenin 68, pika 2 e Rregullores, projektligji në relacionin e tij parashikon nevojën për zhvillim të qëndrueshëm, por nuk i referohet asnjë objekti të Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

#### ***Përputhësia me Acquis e Bashkimit Evropian***

Ligji nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura është përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 maj 1992, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër”, të ndryshuar”, Numri CELEX 31992L0043, ndërsa projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” nuk synon të përafrojë asnjë direktive europiane dhe për rrjedhojë nuk ka një tabelë shoqëruese për përafrimin e legjislacionit.

- ***Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026***

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” është pjesë e Kapitullit 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”, të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026, por nuk është parashikuar në këtë plan.

- ***Aspektet materiale të përafrimit***

#### **Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit të propozuar**

#### **Legjislacioni parësor i BE-së:**

- *Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE): Pjesa e parë “Parimet”, Titulli I “Kategoritë dhe fushat e kompetencës së Bashkimit”, Neni 4, pika 2, shkronja (e); Titulli II “Dispozita me zbatim të përgjithshëm”, Neni 11 (ish-neni 6 TKE), Pjesa e tretë “Politikat dhe veprimet e brendshme të bashkimit”, Titulli XX “mjedisi”, Nenet 191-193 (ish-nenet 174-176 TKE),*
- *Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Neni 108 “Mjedisi”.*
- *Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European: Titulli IV “Solidariteti”, Neni 37 “Mbrotjtja mjedisore”.*

**Legjislacioni dytësor i BE-së:**

- *Direktiva e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 Maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër”, e ndryshuar”.*

**Neni 4, pika 2, shkronja (e) e TFBE-së,** parashikon se në fushën e mjedisit zbatohet kompetencë e ndarë midis Bashkimit dhe Shteteve Anëtare.

**Neni 11 i TFBE-së,** parashikon se kërkesat për mbrojtjen e mjedisit duhet të integrohen në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit, sidomos me synim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

**Neni 191 i TFBE-së,** parashikon se politika e Bashkimit për mjedisin kontribuon në arritjen e objektivave të tillë si:– ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, – mbrojtja e shëndetit të njeriut, – shfrytëzimi i kujdesshëm dhe racional i burimeve natyrore, – promovimi i masave në nivel ndërkombëtar për të trajtuar probleme mjedisore rajonale ose botërore, dhe në veçanti për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ka si qëllim një nivel të lartë mbrojtjeje, duke marrë në konsideratë larminë e situatave në rajonet e ndryshme të Bashkimit. Ajo mbështetet në parimin parandalues dhe në parimet se duhen marrë masa parandaluese, që dëmi ndaj mjedisit si përparësi duhet ndrequr në burim dhe që ndotësi duhet të paguajë.

**Neni 192 i TFBE-së,** parashikon procedurën dhe çfarë veprimi duhet të ndërmarrë Bashkimi për të arritur objektivat e përmendur në nenin 191.

**Neni 193 i TFBE-së,** parashikon se masat mbrojtëse të miratuara në zbatim të nenit 192 nuk i pengojnë Shtetet Anëtare që të mbajnë ose të marrin masa mbrojtëse më të shtrënguara, të cilat gjithmonë duhet të jenë në pajtim me Traktatet.

**Neni 108 i MSA-së,** parashikon se palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit për fushën e mjedisit.

**Neni 37 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European,** parashikon se një nivel i lartë i mbrojtjes mjedisore si edhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit duhet të integrohen në politikat e Bashkimit si dhe të garantohen në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

**Neni 2 i Direktivës së Këshillit 92/43/KEE,** parashikon se qëllimi i kësaj direktive është të kontribuojë në sigurimin e biodiversitetit nëpërmjet ruajtjes së habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër në territorin evropian të Shteteve Anëtare për të cilat zbatohet Traktati. Masat e marra në përputhje me këtë direktivë do të hartohen për të ruajtur ose rivendosur, në

status të favorshëm ruajtjeje, habitatet natyrore dhe speciet e faunës dhe florës së egër me interes të Komunitetit dhe do të marrin parasysh kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe karakteristikat rajonale dhe lokale.

- **Konsultimi publik**

Projektligji është publikuar në platformën e konsultimit publik nga Komisioni përgjegjës dhe ka marrë në total 12 komente: 2 komente nga individë, 1 koment nga lobistë dhe 9 komente nga organizata të ndryshme. Të gjitha komentet do të trajtohen nga komisioni përgjegjës.

- ***Efektet financiare të aktit***

Sipas relacionit shoqërues, projektligji nuk parashikon efekte financiare.

- ***Diskutimi në komision***

Z. Fadil Nasufi në cilësinë e propozuesit paraqiti projektligjin dhe theksoi se kjo nisëm vjen si kërkesë e 15 Bashkive të vendit, për arsye të problematikave të hasura gjatë zbatimit të ligjit. Propozimet për ndryshime kërkojnë t'i japin zgjidhje disa problemeve që janë krijuar gjatë këtyre viteve të tranzicionit. Gjithashtu këto propozime synojnë sigurimin e të ardhurave dhe përfitimeve nga shfrytëzimi i zonave të ndryshme për banorët e zonave të mbrojtura.

Z. Etjen Xhafaj në cilësinë e relatorit theksoi se projektligji vjen si nevojë e rregullimit të mëtejshëm të zonave të mbrojtura, në interes të banorëve të këtyre zonave, si dhe kërkon të rrisë mbrojtjen e tyre. Projektligji nuk synon përafrimin e legjislacionit të BE-së.

- ***Ndryshime të projektaktit (nen për nen)***

Komisioni për Çështjet Evropiane nuk ka propozuar asnjë amendament.

## **SUGJERIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, **nuk përafron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të Bashkimit European** (acquis e BE-së/ i.e Direktivë, Rregullore apo Vendim).

Pavarësisht kësaj, projektligji duhet të respektojë parimet e Direktivës 92/43/KEE, që lidhen me menaxhimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura, duke i trajtuar ato si zona të një rëndësie të veçantë dhe duke siguruar mbrojtjen mjedisore dhe të biodiversitetit të natyrës në to.

Gjithashtu projektligji duhet të respektojë parimet e IUCN-së, në të cilat përcaktohet se *konsiderohen zona të mbrojtura ato të cilat kanë si objektiv kryesor dhe synojnë ruajtjen e natyrës ose, në mënyrë ideale, të rrisin shkallën e natyralitetit të ekosistemit që mbrohet dhe të parandalojnë, ose eliminojnë aty ku është e nevojshme, çdo praktikë shfrytëzimi ose menaxhimi që është e dëmshme për këtë objektiv.*

Për këtë arsye sugjerojmë që neni 7 shkronja (d) dhe (dh), neni 8, pika 3, shkronja (f) dhe neni 10, pika 1, i projektligjit, të rishikohen për të qenë në përputhje me nenin 108 të MSA-së, nenin 37 të Kartës të Drejtave Themelore të BE, në linjë me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, konkretisht nenin 6, pika 2, 3 dhe 4 të saj, si dhe në linjë me parimet e IUCN-së.

## ***Përfundim***

Komisioni për Çështjet Evropiane, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;
- Projektligji nuk synon të për afrojë ndonjë direktivë të BE-së
- Pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm (10 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim) e miratoi atë në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe u shpreh dakord për t'ia përcjellë Komisionit përgjegjës së bashku me sugjerimet e mësipërme për nenet **7 shkronja (d) dhe (dh), neni 8, pika 3, shkronja (f) dhe neni 10, pika 1, i projektligjit** për të vijuar me procedurat sipas Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e tij :

**RELATOR**

**ETJEN XHAFAJ**

**ZËVENDËSKRYETARE**

**ETILDA GJONAJ**